

RAPORTI I AKTIVITETEVE PËR VITIN 2020

HYRJE

Qendra Kinematografike e Kosovës (QKK) është fondi publik i filmave dhe autoriteti qendror për kinematografinë në Kosovë që financon filma artistikë, filma të shkurtër, dokumentarë, filma animacioni, zhvillime të projekteve dhe post-produksionit. Në 5 vitet e fundit përmes përkrahjes së QKK-së dhe punës e bashkëpunimit të ngushtë me komunitetin filmbërës, kinematografija ka shënuar rritje eksponenciale të suksesit në arenën ndërkombëtare të filmit. Filmat e shkurtër, të gjatë dhe ata dokumentarë të Kosovës kanë rritur praninë e tyre në festivale të rëndësishme evropiane dhe botërore të filmit. Filmat kosovarë janë shfaqur në festivalet më të rëndësishme ndërkombëtare të filmave si Berlinale, Sundance, Toronto, Sarajevë, Karlovy Vary, Montreal, Cairo, Goa, Tallinn e deri në nominimin për Oscars®. Gjatë 10 viteve të fundit Qendra Kinematografike e Kosovës ka mbështetur afër 140 filma në kategori të ndryshme dhe ka pasur bashkëpunime me shumë shtete që kanë forcuar industrinë e bashkëprodhimit të filmave.

HAPJA DHE MBYLLJA E KONKURSIT PËR SUBVENCIONIM TË PROJEKTEVE FILMIKE PËR VITIN 2020

Me 31 gusht u mbyll konkursi vjetor për subvencionim të projekteve filmike. Pas mbylljes së konkursit komisioni i konkursit vërtetoi që këtë vit aplikuan gjithsej 71 projekte filmike.

Nga këto projekte:

12 projekte kanë aplikuar në kategorinë e metrazhit të gjatë artistik;

11 projekte në kategorinë e bashkëprodhimeve minorë për film të metrazhit të gjatë artistik

6 projekte në kategorinë e filmit të metrazhit të gjatë dokumentar

3 projekte në kategorinë për postproduksion të filmit të metrazhit të gjatë artistik

1 projekt në kategorinë e filmave të regjisorëve debutant

14 projekte në kategorinë e filmave të shkurtër artistik

3 projekte në kategorinë e filmave të shkurtër dokumentar

5 projekte në kategorinë e filmave të shkurtër të animuar


16 projekte në kategorinë për zhvillim skenari për film të metrazhit të gjatë artistik, dokumentarë, dhe të animuar.

Pas mbylljes së konkursit është formuar komisioni i konkursit i cili verifikon secilin aplikacion se a i plotëson kriteret e përcaktuara me konkurs dhe aktet ligjore në fuqi. Me përfundimin e procesit të punës së komisionit të konkursit dhe atij financiar, do të emërohet juria vlerësuese të cilët shqyrtojnë dhe vlerësojnë projektet. Listën e plotë të aplikuesve mund ta gjeni në seksionin e njoftimeve zyrtare në linkun:

<https://qkk-rks.com/sq-al/njoftimet-zyrtare/>

PJESA E DYTË E APLIKIMEVE NË FAMU PËR VTITIN 2020 – KU OFROHET RAUNDI I DYTË I PROGRAMIT TË MONTAZHËS

Shkolla e filmit dhe televizionit e Akademisë së Arteve të Bukura në Pragë – FAMU sivjet ka ofruar raundin e dytë të programit të masterit për montazhë. Inkurajohen të gjithë të interesuarit e fushës së filmit shtetas të Kosovës të aplikojnë. Afati i fundit për aplikim ishte 24 korriku, 2020.



Ky ishte viti i gjashtë me radhë që Qendra Kinematografike e Kosovës dhe MKRS-ja mundëson financimin e shkollës së filmit dhe televizionit në Pragë – FAMU. FAMU është themeluar me dekret presidencial në vitin 1945 dhe ofron programe të akredituara dhe të çertifikuara të studimit si në gjuhën çeke ashtu edhe në atë angleze.

Memorandumi i lidhur mes QKK-së, MKRS-së dhe FAMU-së, ofron mundësinë e edukimit audio-vizual për qytetarët e Republikës së Kosovës në këtë Akademi. Bursa vlen vetëm për shtetas të Republikës së Kosovës me vendbanim të përhershëm në Kosovë.

PREMIERAT, PJESËMARRJET DHE ÇMIMET E FILMAVE TË KOSOVËS GJATË 3 MUJORIT KORRIK, GUSHT, SHTATOR 2020

‘GALAKTIKA E ANDROMEDËS’ DHE ‘EXIL’ NË KATEGORINË KRYESORE TË FESTIVALIT TË SARAJEVËS

‘Galaktika e Andromedës’, filmi debutues nga More Raça dhe ‘Exil’ nga Visar Morina ishin pjesë e kategorisë kryesore në edicionin e sivjetëm të Festivalit të Sarajevës që u mbajt nga data 14 deri më 21 gusht.

Më rastin e publikimit të programit të Festivalit të Sarajevës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Znj. Vlora Dumoshi i uroi regjisorët dhe ekipet e realizuese përmes një videotelefionate të përbashkët. “Më gëzoi lajmi që dy filmat ‘Galaktika e Andromedës’ nga More Raça dhe ‘Exil’ nga Visar Morina do të jenë pjesë e kategorisë kryesore të Festivalit të Filmit në Sarajevë. Uroj nga zemra dy regjisorët kosovarë dhe ekipet realizuese të të dy filmave për këtë arritje të rëndësishme për ta si regjisorë dhe për kulturën e Kosovës në përgjithësi.



MKRS-ja do të përkrahë gjithmonë iniciativa dhe projekte filmike që kanë kualitet të nivelit evropian, dhe me anë të të cilëve prezantojmë shtetin dhe kulturën tonë në arenën ndërkombëtare”, u shpreh ministria Dumoshi. Duke u bazuar në rezultatet pozitive të filmave të autorëve vendas dhe atyre të bashkëprodhuara ministria Dumoshi është koshiente që duhet të punohet në drejtim të rritjes së buxhetit dhe mbështetjes së sektorit të industrisë së filmit në Kosovë.

Kjo ishte premierë e rëndësishme për regjisoren e re More Raça. ‘Galaktika e Andromedës’ filmi im i parë i metrazhit të gjatë në festivalin prestigjioz prej më të mëdhenjëve në rajon Sarajevo Film Festival, lajm shumë i gëzueshëm për mua si autore dhe për ekipin e filmit” u shpreh regjisorja More Raça.

Përderisa ‘Exil’-i kishte premierën botërore në festivalin e madh të Sundance në SHBA, dhe atë evropiane në Berlinale në shkurt të këtij viti, kjo ishte premiera rajonale e filmit nga regjisori kosovar Visar Morina.

Linku i zoom thirrjes: https://youtu.be/_1SCsSa23x8

Linku zyrtar i Festivalit të Sarajevës:

<https://www.sff.ba/en/news/11313/26th-sarajevo-film-festival-49-films-to-compete-for-heart-of-sarajevo-awards>

EDHE ‘ZANA’ PJESE E FESTIVALIT TË FILMIT TË SARAJEVËS

Filmi i gjatë aristik me regji të Antoneta Kastratit ishte pjesë e programit ‘In Focus’ në Festivalin e Sarajevës. ‘In Focus’ është program dedikuar filmave rajonal të jashtëzakonshëm të cilët tashmë kanë bërë sukses të konsiderueshëm në festivalet prestigjioze të filmit në botë.

‘Zana’ ishte filmi i tretë nga Kosova që u bë pjesë e Festivalit të Sarajevës pas njoftimit të mëhershëm për pjesëmarrja në konkurrencë kryesore të filmit ‘Galaktika e Andromedës’ dhe ‘Exil’-it.



Filmi 'Zana' me producent Casey Cooper Jonson kishte premierën botërore në Festivalin e madh të Torontos në shtatorin e kaluar dhe përfaqësoi Evropën në Festivalin ndërkombëtar në Sydney të Australisë, është bashkëprodhim në mes Kosovës, Shqipërisë dhe SHBA-ve, dhe financuar nga Qendra Kinematografike Kosovës dhe Qendra Kombëtare e Kinematografisë në Shqipëri.

Linku zyrtar i festivalit:

<https://www.sff.ba/en/news/11344/in-focus-2020>

'VERA ANDRRON DETIN' FITOI ÇMIMIN E POSTREPUBLIC NË VLERË TË 50 MIJË EURO NË SARAJEVË

Filmi i gjatë artistik 'Vera Andrron Detin' me regji të Kaltrina Krasniqit dhe skenar të Doruntina Bashës, i cili është në fazën e postproduksionit dhe që ishte pjesë e programit 'Work in Progress' në kuadër të festivalit fitoi çmimin kryesor në këtë kategori.

CineLink Works in Progress

Post Republic Award

VERA DREAMS OF THE SEA

by Kaltrina Krasniqi

Filmi ka për personazh kryesor një 64-vjeçare përkthyesë e gjuhës së shenjave, që jeton në Kosovë. Ajo e sfidon burrin e saj patriarkal me qëllim që të mbrojë vajzën e saj të cilën ai e ka mohuar.

Filmi "Vera Andrron Detin" me producent Shkumbin Istrefin, është bashkëprodhim i Puntoria Kreative Isstra (Kosovë), Dream Factory (Maqedoni e Veriut) dhe Papadimitri Production (Shqipëri), dhe është mbështetur nga Qendra Kinematografike Kosovës, Agjensioni i Filmit i Maqedonisë Veriore dhe Qendra Kombëtare e Kinemaografisë në Shqipëri.

FILMI 'EXIL' NGA VISAR MORINA RRËMBEU 'ZEMRËN E SARAJEVËS'

'Exil' sonte në Sarajevë duke e fituar çmimin kryesorë të festivalit 'Zemrën e Sarajevës' në një ceremoni të organizuar online për shkak të situatës së krijuar nga Covid-19.

Këtë vit juria e programit kryesor garues përbëhej nga regjisori francez Michel Hazanavicius, drejtori artistik i Festivalit të Berlinit Carlo Chatrian, aktorja kroate Jadranka Djokic, regjisori serb Srđan Golubovic dhe nga ekspertja e industrisë nga Meksika Andrea Stavenhagen. Në një video të dërguar, regjisori Morina

shprehet mjaft i lumtur me çmimin: 'Jam shumë i gëzuar me çmimin, faleminderit! E kisha një vit shumë të ngarkuar në realizimin e këtij filmi dhe nganjëherë ndihesha më i humbur se karakteri i filmit, e ky çmim më ndihmon shumë. Falemnderit jurisë dhe festivalit'.




Filmi i cili u shpërblye edhe nga magazina evropiane Cineuropa për regjinë më të mirë, rrëfen tregimin e Xhaferit, një inxhinier i kimisë me origjinë nga Kosova, i cili ndjehet i diskriminuar dhe i ngacmuar në vendin e punës, gjë që e zhytë atë në krizë të identitetit.

“Exil”-i sjell një kastë brilante të aktorëve, si: Sandra Hüller, Mišel Matieviq, Flonja Kodheli, Getuart Hajrizaj, Astrit Kabashi, Valentina Dubovci, Ameli Kabashi etj.

Ky edicion i Festivalit të Sarajevës kishte një presence të madhe të kinematografisë së Kosovës ku përveç pjesëmarrjes së filmit ‘Exil’ ishin edhe ‘Galaktika e Andromedës’, ‘Zana’ dhe ‘Vera Andrron Detin’.

QKK-ja NË MAKECOPRODOX FORUM

Forumi MakeCoProDox është një forum qëllimi kryesor i të cilit është të zhvillojë një plan strategjik për të rritur bashkëprodhimin e filmit dokumentar midis vendeve të Ballkanit.



Këtë vit forumi mirëpriti:

- 12 përfaqësues të fondeve të filmit nga vendet e rajonit (N. Maqedonia, Serbia, Kroacia, Sllovenia, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina, Shqipëria, Bullgaria, Greqia, Kosova, Rumania dhe Turqia)
- Përfaqësues nga Fondet Skandinave të Filmit (Suedi, Danimarkë, Norvegji)
- Përfaqësuesit e transmetuesve televizivë (HBO Europe, Al Jazeera, Current Time TV)
- Përfaqësues (programues filmash) nga FestDocsNetwork (DokMunchen, DocsBarcelona, FipaDoc, MakeDox)
- Shpërndarës të filmave nga rajoni
- Prodhuesit vendas në mënyrë që të lehtësojnë kërkimin e prodhimeve vendore
- Përfaqësues të Shoqatave të Dokumentarëve

Për shkak të situates me COVID- 19, ky edicion i MakeCoProDox u mbajt në internet.

HAPJA E THIRRJES PËR PROPOZIME PËR OSCAR, ÇAKTIMI I KOMITETI SELEKTUES, DHE KORDINIMI ME OSCARS!

Me 15 shtator u ftuan të gjithë të interesuarit që të dërgojnë propozime për konsiderim për çmimin OSCAR për kategorinë për film në gjuhë të huaj (international feature), i cili mund ta përfaqësoj Kosovën këtë vit.

Në këtë kategori përfshihen filmat e metrazhit të gjatë artistik, dokumentarë, dhe të animuar më të gjatë se 40 minuta, që janë shfaqur në kinema apo VOD platformë për së paku 7 ditë rresht, jo më herët se 1 tetor 2019 dhe jo më vonë se 31 dhjetor 2020.

Përkrah të pandemisë, Akademia e Oscars ka përcaktuar disa rregulla të reja. Ndër to kryesorja që do të vlej vetëm për edicionin e 93të është për: filmat e përzgjedhur që e kanë pasur shfaqjen teatrale të planifikuar më parë, por që fillimisht janë bërë të qasshme përmes platforme me reputacion të shpërndarjes, ose të ndonjë platforme VOD, mund të kualifikohen, nën kushtet e mëposhtme:

- Që ti sigurojnë Akademisë dokumentacionin (dokumentin origjinal dhe një përkthim në anglisht) të datave të mbylljes së kinemasë të mandatuar nga qeveria, dokumentacionin që dëshmon shfaqjen në kinema të planifikuar më parë, dhe shpërndarjen në një platformë me reputacion, ose marrëveshje me ndonjë platformë VOD.
- Filmi do të vihet në dispozicion në Dhomën e Shfaqjes së Akademisë brenda 60 ditëve pasi filmi është përcaktuar zyrtarisht nga komiteti përzgjedhës për të përfaqësuar vendin.
- Që plotëson të gjitha kriteret e tjera të pranueshmërisë.

Data e fundit për dërgimin e propozimeve u caktua 30 shtatori 2020.



Komiteti selektues i aprovuar nga Akademia e Çmimeve Oscars u caktua të përbëhet nga kineastët kosovarë: Sevdije Kastrati, Alban Ukaj, Kaltrina Krasniqi, Bujar Kabashi, Doruntina Basha, Ilir Gjocaj, dhe Kreshnik Keka Berisha të pastaj u kordinuan dhe mbledhën për të përzgjedhur propozimin e Kosovës për Oscars.

SHFAQJA E PREMIERËS SË FILMIT ‘ONLY HUMAN’ (‘HOMO’) NË SHKUP

Filmi i gjatë artistic ‘Homo’/’Only Human’ nga Igor Ivanov dhe me bashkëproducent Lumbradh Kukajn shfaq premierën në Shkup me 24 shtator.

Në film luajnë edhe aktorët kosovar Majlinda Kasumoviq dhe Basri Lushtaku.

Filmi paraqet gjashtë fytyra në gjashtë episode komike të ndërthurura me zgjuarsi, përmes komedisë së zezë.



Personazhet e dëshpëruara takohen padashur në një metropol modern, përderisa mundohen të mënyra për të mbijetuar dhe për të gjetur dashurinë.

Filmi është bashkëprodhim në mes Maqedonisë Veriore, Bullgarisë, Kosovës, Serbisë dhe Sllovenisë.

FILMIT 'ZANA' PËRFUNDOI MUAJIN E FILMIT TË KOSOVËS NË BERN

Në fund të muajit shtator në kinemanë Kino in der Reitschule të Bernit u shfaq filmi 'Zana' nga Antoneta Kastrati. Me shfaqjen e filmit 'Zana' përfundoi edhe muaji filmit të Kosovës në Bern, organizuar nga KulturaLink në bashkëpunim me Kino in der Reitschule dhe Qendrën Kinematografike të Kosovës.



September 2020 - KINO KOSOVA in Kino in der Reitschule

Kulturalink and Kino in der Reitschule are planning a series of events in September 2020 in Bern. The month of September will be dedicated to movies produced in Kosovo and the Diaspora, tackling different aspects of kosovar (and european) society, such as migration, gender roles, etc. Society is reflected in movies and in turn, movies influence society by changes in representations and transforming viewers' opinions. The films have been selected for their potential to reflect the struggles and desires of a young nation located on the geographical and political margins of Europe. An important goal of this project is to invite directors to the screenings, giving them the opportunity to give further insight into their work and to interact with the audience. "Transforming the way people see the world through film" is our mission statement, and we endeavor to inspire audiences to express themselves and their cultural perspectives through the shared experience of the moving image — regardless of ethnicity, ability, or socioeconomic status.



Gjatë shtatorit u shfaqën këta filma: 'Sans Les' nga Dea Gjinovci, 'Toni & Bleri' nga Katja Verheul, 'Zvicra' nga Fisnik Maxhuni dhe Benoît Goncerut, 'Me dasht' me dasht' me dasht' nga Ilir Hasanaj, 'Nëntor i Ftohtë' nga Ismet Sijarina, 'Trapped by Law' dhe 'Never Backl Home' nga Sami Mustafa, 'Pick a Name' nga Dritëro Mehmetaj, 'Ajo' nga More Raça, 'Bonu Burrë' nga Pierre-Kastriot Jashari, dhe 'Zana' nga Antoneta Kastrati.

NËNSHKRUHET MARRËVESHJA PËR BASHKËPRODHIM FILMIK NË MES KOSOVËS DHE SHQIPËRISË

Në fillim të muajit tetor në Tiranë në mbledhjen e të dy qeverive, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit znj. Dumoshi dhe Ministria e Kulturës znj. Margariti, nënshkruan marrëveshjen që përcakton bashkëprodhimin filmik në mes të Kosovës dhe Shqipërisë.



Kjo marrëveshje do të intensifikojë bashkëpunimin ndërmjet dy institucioneve filmike, Qendrës Kinematografike të Kosovës dhe Qendrës Kombëtare të Kinematografisë së Shqipërisë në bashkëprodhimin e filmave.

Marrëveshja parasheh edhe ndarjen e çmimeve vjetore kombëtare të përbashkëta në fushën e kinematografisë ceremonitë e të cilave pritet të ndodhin njërin vit në Tiranë dhe tjetrin në Prishtinë. Procedurat për ndarjen e çmimeve kombëtare për kinematografi do të bëhen me një rregullore të veçantë.

Kjo marrëveshje poashtu parasheh promovimin e ndërsjellë të filmave nga të dyja vendet, promovimin ndërkombëtar të përbashkët, si dhe e bën edhe iniciimin e themelimit të fondit të përbashkët për kinematografi që do t'i shërbente bashkëprodhimit në mes të dy vendeve si interes kombëtar.

“Cirku Fluturues” i regjisorit Fatos Berisha triumfon në Francë



Filmi “Cirku flututues” i regjisorit Fatos Berisha dhe producente Vjosa Berisha fitoi Grand Jury Prix / Çmimin kryesor në War on Screen IFF, Chalons en Champagne!

FILMI ‘EXIL’ NGA VISAR MORINA ËSHTË KANDIDATI I KOSOVËS PËR OSCARS 2021

Pas ‘Babai’-t në 2016, ‘Exil’-i do të jetë filmi i dytë lartëvlerësuar i Visar Morinës që Kosova propozon për OSCARS. Në gusht ‘Exil’-i fitoi çmimin kryesor të Festivalit të Sarajevës, Zemrën e Sarajevës në kuadër të kategorisë kryesore.



Ndërsa në janar dhe shkurt filmi shfaqti premierën botërore dhe atë evropiane në Sundance dhe Berlinale. Këtë javë 'Exil'-i u përzgjedh nga komiteti selektues që të jetë propozimi i Kosovës për kategorinë Best International Feature të Oscars.

Filmi përçjellë Xhaferin me origjinë nga Kosova (luajtur nga Misel Maticevic), një inxhinier i kimisë që jeton në Gjermani i cili dyshon që është bërë shënjestër e kolegëve të tij racistë.

"EKZILI" është një portret i mprehtë i gjeneratës së integruar të emigranteve, gjenerate kjo që rrallë e shohim në film, të cilët pavarësisht arritjeve personale rrallë lirohen nga ndjenja e të qenit të huaj. Konsiderojmë se ky film flet në mënyrë shumë univerzale, jo vetëm për shqiptarët, por për të gjithë ata që largohen nga vendlindjet e tyre për të gjetur qytete të reja që kurrë nuk u shëndërruan në shtëpi. Ekzili shtyen për një dialog aq të munguar mbi politikat e mikpritjes." ishte deklarata e komitetit selektues pas përzgjedhjes së filmit.

'Exil'-i është bashkëprodhim në mes Gjermanisë, Kosovës dhe Belgjikës, prodhuar nga Komplizen Film - Gjermani, Ikonë Studio - Kosovë dhe Frakas nga Belgjika.

Komiteti selektues i aprovuar nga Akademia e Çmimeve Oscars ishte e përbërë nga kineastë kosovarë: Sevdije Kastrati, Alban Ukaj, Kaltrina Krasniqi, Bujar Kabashi, Doruntina Basha, Ilir Gjocaj, dhe Kreshnik Keka Berisha.

FILLOI FESTIVALI NDËRKOMBËTAR I FILMIT PRIFEST

Me datë 19 tetor 2020, në ora 15:30 do u hap zyrtarisht online Festivali Ndërkombëtar i Filmit PriFest. Përshkak të pandemisë, këtë vit PriFest ka vendosur të shfaq filmat online.



Prej 19 - 25 tetor, Festivali shfaq gjithsej 36 filma, që të gjitha premiera në Kosovë, 2 prej tyre premiera botërore, 2 premiera ndërkombëtare, 1 premierë evropiane dhe 6 premiera regjionale.

PËRZGJEDHEN 5 AKTORËT E KOSOVËS PËR SPOTLIGHT

Në bashkëpunimin e sivjetëm me Spotlight, PriFest ka mundësuar anëtarësimin për pesë aktorët Kosovarë, për 1 vit falas, në njërin nga kompanitë më të njohura për shërbime kastingu në Evropë.


Aktorët e përzgjedhur janë:

May Linda Kosumovic,
Rozafa Çelaj,
Shkumbin Istrefi,
Kushtrim Hoxha,
Shpëtim Selmani.

Spotlight është shërbim kastingu që lidh aktorët me role në teatër, televizion dhe projekte filmike. Profesionistët e kastingut përmes Spotlight bëjnë përzgjedhjen e aktorëve për projektet e veta pasi Spotlight njihet si kompania më e mirë në këtë industry. Me studiot e veta në West End të Londrës si dhe ekipet e stafit në çdo kënd të Evropës, Spotlight ndodhet mu në qendër të industrisë së arteve skenike. Përkrah partnerëve në Evropë, Amerikë e Australi, moto e Spotlight në të cilën besojnë fuqishëm është se casting është një punë me të vërtetë globale dhe një aktor që mund të përshtatet për një rol apo punë mund të vijë nga kudo në botë.

Aktorët e përzgjedhur do t'i nënshtrohen një workshopi (punëtorie) parapregatitor me datën 5 nëntor, për të mësuar se si mund të perdoret platforma Spotlight në mënyrë më efektive për aplikim në projekte filmike apo të teatrit jashtë Kosovës.

Të pesë aktorët kanë fituar anëtarësimin falas në këtë platformë falë bashkëpunimit të PriFest me Spotlight, bashkëpunim ky që do të zhvillohet edhe më shumë në vitet në vazhdim.



Poashtu, javën e kaluar, PriFest kishte organizuar një masterclass me Spotlight për të gjithë aktorët dhe filmbërësit e Kosovës brenda javës së edicionit të 12-të të festivalit.

Edicioni i ardhshëm i PriFest, i 13-ti me rradhë, do të mbahet nga 13-18 korrik 2021.

THIRRJE PËR NOMINIM TË AKTORËVE PËR EFP SHOOTING STARS - BERLINALE 2021

EUROPEAN SHOOTING STARS organizohet nga EFP (European Film Promotion) dhe është program i cili promovon aktorë të rinj premtues nga e gjithë Evropa, duke i sjellë në qendër të vëmendjes evropiane. Për 20 vite me radhë, Shooting Stars ka qenë hapë shumë i rëndësishëm për fillimin e karrierës ndërkombëtare të shumë aktorëve evropian të suksesshëm.



Afati për dërgimin e nominimeve ishte 30 tetori. Nominimet u dërgohuan në info@qkk-rks.com.

Kriteret për nominimin e aktoreve / aktorëve:

- të ketë potencial për të punuar ndërkombëtarisht. I nominuari duhet të ketë përvojë në vendin e saj/tij por duhet të jetë prurje për skenën ndërkombëtare të filmit.
- të ketë një rol kryesor në filmin me metrazh të gjatë ose serialin dramatik të nivelit të lartë (për shfaqje ndërkombëtare) për të cilin aktori është nominuar. Filmi i lidhur me nominimin ka pasur Premierën e tij Botërore në një festival ose në një lansim kombëtar nga marsi i vitit 2020 e tutje; ose është një prodhim i ardhshëm ose Work-in-Progress, që do të dalë gjatë 2021. Ideale do të ishte nëse filmi është një prodhim i ri, duke u përgatitur për festivalet e ardhshme (dmth. Berlinale ose të tjera). Kjo do të garantonte që filmi do të ishte një pjesë

integrale e fushatës promovuese për Shooting Stars gjatë gjithë vitit, si dhe në Berlinale (fushatë promovimi në internet që zgjatë rreth një vit). Nëse aktori është nominuar me një serial dramatik, ose seriali duhet të jetë i ri (i vitit 2020) ose paraqitja e aktorit në serial duhet të jetë e vitit 2020. Ju lutemi mbani në mend se na duhet vido-material i mjaftueshëm për shqyrtimin e jurisë dhe për fushatën pasuese promovuese.

- të jetë mbi 16 vjeç Kufirin i kaluar i moshës (32 vjeç/e) është hequr, por këshillojmë që të mos emërojmë aktorë më të vjetër se rreth 45 për këtë vit tranzitor.
- aktorët të kenë njohuri të gjuhës angleze dhe të jenë në gjendje të shprehen rrjedhshëm në anglisht.
- të jetë fizikisht i disponueshëm gjatë Festivalit Ndërkombëtar të Filmit në Berlin (11-17 shkurt 2021) dhe të jetë virtualisht i disponueshëm para dhe pas festivalit (fushata promovuese).
- të jenë të gatshëm të marrin një rol aktiv në fushatën promovuese të Shooting Stars. Aktori / aktorja të nënshkruajë letrën e bashkangjitur të zotimit.

ADRIANA MATOSHI ZGJEDHET AKTORJA MË E MIRË NË MOSTRA DE VALENCIA

Aktorja kosovare Adriana Matoshi fitoi çmimin e aktores më të mirë (best female performance) në festivalin spanjoll - Mostra de Valencia për rolin e Lumes në filmin ZANA të regjisores Antoneta Kastrati. Përveç tek “Zana”, Adriana luan në rrolet kryesore tek shumë prej filmave më të rëndësishëm kosovar të viteve të fundit si: “Shpia e Agës”, “Nëntor i Ftohtë”, “Martesa”, “T’padashtun”, “Gardhi”, “Babai”, “Kthimi” etj.



Karakteri i Lumes të cilin e luan Adriana tek “Zana”, është një grua e re kosovare që përpiqet të bëhet nënë përderisa ballafaqohet me tmerret nga kaluara e saj traumatike e kohës së luftës. Pas premierës në Toronto vitin e kaluar, ‘Zana’ kishte një rrugëtim të suksesshëm në festivale botërore.

KOSOVA DHE TURQIA NËNSHKRUAJNË MARRËVESHJE PËR BASHKËPROD HIM NË FUSHËN E KINEMATOGRAFISË

Ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Kosovës, Vlora Dumoshi dhe Ministri i Kulturës dhe Turizmit i Turqisë, Mehmet Nuri Ersoy, kanë nënshkruar sot marrëveshjen ndërshtetërore e cila do të rregullojë dhe promovojë bashkëprodhimin filmik në mes të Kosovës dhe Turqisë.



Marrëveshja e nënshkruar ka për qëllim që të përcaktojë bazat që kanë të bëjnë me prodhimin e përbashkët të Filmit dhe Serive televizive.

Me qëllim të zbatimit dhe funksionimit efektiv marrëveshja përcakton themelimin e nënkomisionit për bashkëprodhimet e filmave dhe serive televizive, të përbërë nga përfaqësuesit e autoriteteve kompetente të secilës palë dhe të bashkëkryesuara nga palët.

Ministrja Dumoshi është shprehur shumë e lumtur për nënshkrimin e kësaj marrëveshje: “Kjo marrëveshje përtej detajeve dhe modaliteteve që përcakton, ka një rëndësi të madhe për bashkëpunimin kulturor, sidomos atij në fushën e kinematografisë, midis Kosovës dhe Turqisë dhe për marrëdhëniet bilaterale mes dy vendeve”, ka theksuar ministrja Dumoshi.

FILMI “GALAKTIKA E ANDROMEDËS” PJESË E FESTIVALIT NË CAIRO

Pas premierës në Sarajevë, filmi “Galaktika Andromedes” nga More Raça u shfaqe në festivalin e kategorisë 'A' – në Cairo International Film Festival, Critics Week Competition që u mbajt nga data 1 deri me 10 dhjetor 2020.

